



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
SEKTORI I ARSIMIT KULTURËS DHE SPORTEVE

Nr 3031 Prot.

Urë Vajgurore më, 22 / 09 / 2023

Lënda: “Mbi miratimin e prishjes (mbylljes) së Shoqërisë Aksionare “FK OSUMI SH.A”

KËSHILLIT BASHKIAK DIMAL

I Nderuar Z. Kryetar i Këshillit Bashkiak / Të Nderuar Zonja dhe Zotërinj të Këshillit Bashkiak Dimal!

Këshilli i Bashkisë Dimal në mbledhjen e datës ____ / ____ / 2023, mbi bazën e materialit të paraqitur nga Zyra e Arsimit Kulturës dhe Sporteve pranë Bashkisë Dimal, në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Neni 25: “Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese”, Neni 9: “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, Neni 25: “Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese”, Neni 53: “Funksionimi i këshillit bashkiak”, si edhe Neni 54: “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak”, Neni 55: “Votimi”, Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Titullit VII “Prishja (mbyllja) e shoqërisë”, Nenit 187: “Shkaqet e prishjes (mbylljes) së shoqërisë”;

Kërkojmë miratimin tuaj për prishjen (mbylljen) e shoqërisë aksionare “FK OSUMI SH.A” të miratuar me Vendimin Nr. 52, datë 13.05.2019 në zbatim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Titullit VII “Prishja (mbyllja) e shoqërisë”, Neni 187: “Shkaqet e prishjes së shoqërisë” për shkak se nuk janë kryer veprimtari tregtare për dy vjet nga ana e shoqërisë.

Pas miratimit të prishjes (mbylljes) së shoqërisë “FK OSUMI SH.A”, Shoqëria, do të ushtrojë vëmprimtarinë e saj në formën “Shoqatë me anëtarësi” duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura ligjore për regjistrimin e saj pranë Gjykatës.

Për sa më sipër, bashkëlidhur po ju dergojmë Vendimin Nr. 52, datë 13.05.2019, Aktin e Themelimit, si edhe Statutin e Shoqërisë Aksionare "FK OSUMI SH.A".

Në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj!

Konc: Rabushe Hoxha



Konf: Albano Kora



**KRYETAR
JULIANA MEMAJ**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
RAJMONDA SHUKA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
SEKTORI I ARSIMIT KULTURËS DHE SPORTEVE

Nr 303/1 Prot.

Urë Vajgurore më 22.05 / 2023

PROJEKT - VENDIM

“MBI MIRATIMIN E PRISHJES (MBYLLJES) SË SHOQËRISË AKSIONARE “FK OSUMI SH.A”

Këshilli i Bashkisë Dimal në mbledhjen e datës ____/____/2023, mbi bazën e materialit të paraqitur nga Zyra e Arsimit Kulturës dhe Sporteve pranë Bashkisë Dimal në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Neni 25: “Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese”, Neni 9: “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, Neni 25: “Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese”, Neni 53: “Funksionimi i këshillit bashkiak”, si edhe Neni 54: “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak”, Neni 55: “Votimi”, Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Titullit VII “Prishja (mbyllja) e shoqërisë”, Nenit 187: “Shkaqet e prishjes (mbylljes) së shoqërisë”;

VENDOSI

ME _____ VOTA PRO NGA _____ Këshilltarë prezentë

1. Të miratojë mbylljen e shoqërisë aksionare “FK OSUMI SH.A” të miratuar me Vendimin Nr. 52, datë 13.05.2019 në zbatim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Titullit VII “Prishja (mbyllja) e shoqërisë”, Neni 187: “Shkaqet e prishjes së shoqërisë” për arsyet e parashikuara në statut dhe në rastin konkret, pasi nuk janë kryer veprimtari tregtare për dy vjet nga ana e shoqërisë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Arsimit Kulturës dhe Sporteve.


3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat.

Përgatiti

Rabushe Hoxha



Konf: Albano Kora



U pa dhe është konform ligjit
Jurist, Marsela Kumrija



Sekretar i Këshilli Bashkiak
Arta Hoxha



**KRYETAR
JULIANA MEMAJ**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
RAJMONDA SHUKA**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA URA VAJGURE**

**AKT THEMELIMI
I**

SHOQËRISË AKSIONARE

" FK OSUMI " SH.A

Sot, më datë 21/05/ 2019,
Bashkia Ura Vajgure e përfaqësuar sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak, me Nr 52 të datës 13.05.2019 nga Kryetari i saj Znj. Juliana Memaj shtetas shqiptar, i datëlindjës 10.04.1978 , lindur në Berat dhe banues në Ura Vajgure person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës/ letërnjoftimit me nr.H85410075P

i cili ka vendosur krijimin e shoqërisë "FK OSUMI " Sh.a me termat e mëposhtme:

NENI 1

Të themelojë Shoqërinë Tregtare " FK OSUMI" sh.a, në formën e një Shoqërie Aksionare me oferte private. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë Shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri " FK OSUMI" sh.a., sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit sportiv futboll, rritja e vlerave sportive për sportin e futbollit, duke zbuluar elementë të talentuar dhe përgatitja e tyre për të ardhmen e sportit në përgjithësi. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3
Emri, logo dhe vula e Shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “ **FK OSUMI** ” sh.a.

Ajo do të ketë logon e Bashkise Ura Vajguore dhe vulën e saj perkatese.

NENI 4
Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

Organizimi i aktiviteteve sportive të futbollit.

Krijimi i ekipeve zinxhir dhe pjesëmarrja në garat sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit.

Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të Futbollit, dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit kombëtare dhe ndërkombëtare.

Futja në tregun e lojtarëve për të blerë lojtarë sipas nevojave të ekipit.

Aktivitete të tjera në fushën e futbollit për interesat e shoqërisë dhe Komunës.

Shoqëria, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj pas marrjes dhe në përputhje me licencat apo lejet përkatëse.

NENI 5
Selia e Shoqërisë dhe afati i veprimtarisë

Selia e Shoqërisë do të jetë në qytetin Ura Vajguore prane Bashkise Ura Vajguore. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është _____ lekë.

Ai është i ndarë, në _____ aksione të së njëjtës kategori me vlerë nominale prej _____ lekë, për çdo aksion të shlyer për tërësinë e vlerës nominale të tyre. Aksionet janë të numërtuara nga 1 deri _____ aksione.

Aksionerët themelues të Shoqërisë Tregtare “ **FK OSUMI** ” sh.a zotërojnë aksionet në këtë Shoqëri si më poshtë:

Bashkia Ura Vajguore zotëron 100% të vlerës së aksioneve në kapitalin themeltar të Shoqërisë të barabartë me _____ numër aksionesh, me vlerë _____ lekë.

NENI 7 **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para dhe/ose në natyrë i aksionarëve themelues të kësaj Shoqërie.

Kontributi në para do të jetë i përbërë nga shuma prej _____ lekë, që është edhe vlera minimale e kapitalit themeltar për shoqëritë me oferte private.

Kapitali i Shoqërisë do të depozitohet në Bankën "_____" me seli në _____ në llogarinë "Shoqëri në Formim e Sipër" dhe në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate themelimi. Pas regjistrimit, kjo shumë do të kalojë në llogarinë e kësaj shoqërie që do të çelet pranë bankës "_____". Në llogarinë e shoqërisë çelet llogaria "Fondi themeltar i aksionarëve", ku regjistrohet vlera e kapitalit të tyre.

NENI 8 **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar/permiresuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve – organi më i lartë vendimarrës;

Këshilli Mbikqyrës – organ i mbikqyrjes;

Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

NENI 9 **Këshilli Mbikqyrës**

Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë përbëhet nga 3 (*minimumi 3*) anëtarë, të cilët janë caktuar si më poshtë:

Z. _____, shtetas shqiptar, i datëlindjes ____/____/____, lindur në _____, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit/pasaportës me nr. _____;

Z. _____, shtetas shqiptar, i datëlindjes ____/____/____, lindur në _____, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit/pasaportës me nr. _____;

Z. _____, shtetas shqiptar, i datëlindjes ____/____/____, lindur në _____, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit/pasaportës me nr. _____;

Z. _____, shtetas shqiptar, i datëlindjes ____/____/____, lindur në _____, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit/pasaportës me nr. _____;

Kohëzgjatja e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës do të jetë tre vjet. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen.

NENI 10 **Administratori**

Shoqëria administrohet nga Administratori i cili zgjidhet për një afat 3 vjeçar.

Administratori i parë i Shoqërisë “FK OSUMI ” sh.a. është Z. Albano Kora , shtetas shqiptar, i datëlindjes 24.09.1989 lindur në Ure Vajgurore dhe banues në Ura Vajgurore person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. I90924001L

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i saj Z. Alban Kora , i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12.

Aksionari themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, përveçse atij që mund të jetë konkures me atë të shoqërisë “FK OSUMI ” sh.a.

NENI 13.

Mosmarrëveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirëkuptim nga aksionarët themelues dhe, kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga gjykata kompetente.

NENI 14.

Akti i themelimit pasi u gjet sipas vullnetit të përfaqësuesit të aksionarëve themelues dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ana e tyre para noterit të vendit të themelimit të Shoqërisë. Ky Akt Themelimi hartohet në katër kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

S T A T U T I
I
SHOQËRISË AKSIONARE

“FK OSUMI ” SH.A.

Sot, më datë 21/05/2019 me cilësinë e aksionarit themelues:

Sot, më datë 21/05/ 2019,
Bashkia Ura Vajgurore e përfaqësuar sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak, me Nr 52 të datës 13.05.2019 nga Kryetari i saj Znj. Juliana Memaj shtetas shqiptar, i datëlindjës 10.04.1978 , lindur në Berat dhe banues në Ura Vajgurore person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës/ letërnjoftimit me nr.H85410075P

ka vendosur krijimin e shoqërisë “FK OSUMI ” SH.A. me termat e mëposhtme:

KAPITULLI I
FORMA LIGJORE, EMËRTIMI, SELIA E SHOQËRISË

NENI 1
Forma juridike

Në mbështetje të vullnetit të aksionarit themelues të shprehur në aktin e themelimit si dhe në pajtim të plotë me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të Ligjit Nr.9376, date 21.04.2005 “Për Sportin”,(i ndryshuar) dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që drejtojnë këtë aktivitet, themelohet Shoqëria Tregtare “FK OSUMI ” sh.a., e cila do të funksionojë sipas dispozitave të aktit të themelimit dhe këtij statuti.

NENI 2

Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë do të jetë Shoqëria Tregtare “FK OSUMI ” sh.a.,

NENI 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

Aksionarët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë:

Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit.

Krijimi i ekipeve zinxhir për sportin e futbollit, si dhe pjesëmarrja në garat sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit.

Futja në tregun e lojtarëve për të blerë lojtarë sipas nevojave të ekipit.

Aktivitete të tjera në fushën e futbollit për interesat e shoqërisë.

Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të Futbollit, dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit kombëtare dhe ndërkombëtare.

Shoqëria, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

NENI 5

Zbatimi i normave dhe rregullave të organizmave kombëtar dhe ndërkombëtar të futbollit

Gjatë përmbushjes së objektit të veprimtarisë së saj, shoqëria respekton statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e Federatës Shqiptare të Futbollit dhe të FIFA-s e UEFA-s.

Me qëllim pjesëmarrjen në garat sportive kombëtare dhe ndërkombëtare, shoqëria detyrohet të plotësojë të gjitha kriteret licencimit të përcaktuara nga organizmat përkatës të futbollit.

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj vetëm pas marrjes dhe në përputhje me licencat apo lejet përkatëse.

NENI 6

Selia dhe Zyrat e Përfaqësimit

Selia e Shoqërisë do të jetë në qytetin Ura Vajgurore pranë Bashkisë Ura Vajgurore. Veprimtaria e shoqërisë në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë kryhet nga degët e saj, të cilat funksionojnë në rrethe apo ndarje të tjera administrative të Republikës së Shqipërisë nën drejtimin e Administratorit të saj.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Shoqëria mund të çelë degë dhe zyra përfaqësimi të reja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ato hapen dhe prishen me vendim të Administratorit të Përgjithshëm të Shoqërisë.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, AKSIONET, NDRYSHIMET E KAPITALIT

NENI 7

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është _____ lekë. Ai është i ndarë, në ____ aksione të së njëjtës kategori me vlerë nominale prej ____ lekë, për çdo aksion të shlyer për tërësinë e vlerës nominale të tyre. Aksionet janë të numëruara nga 1 deri _____ aksione.

Aksionarët themelues të Shoqërisë Tregtare “FK OSUMI ” sh.a zotërojnë aksionet në këtë shoqëri si më poshtë:

Bashkia Ura Vajgurore , zotëron 100% të vlerës së aksioneve në kapitalin themeltar të Shoqërisë të barabartë me _____numër aksionesh, me vlerë _____ lekë.

NENI 8

Regjistri i Aksioneve

Pronësia e aksioneve vërtetohet nga regjistrimi i tyre në emër të pronarëve në regjistrin e mbajtur për këtë qëllim nga Shoqëria, sipas mënyrës të parashikuar me ligj. Me kërkesën e aksionarit, Shoqëria lëshon një vërtetim të regjistrimit të aksioneve në pronësi të tij.

Administratori i shoqërisë është përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve sipas ligjit.

NENI 9

Zmadhimi i kapitalit themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë mund të zmadhohet sipas mënyrave dhe rregullave të parashikuara në nenet 168 deri 180 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 176 të ligjit të mësipërm, zmadhimi i kapitalit themeltar mund të bëhet vetëm me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme e cila vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote apo përfaqësuesit e tyre, të cilët marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike.

Kapitali themeltar nuk mund të zmadhohet nëse nuk janë shlyer ende kontributet për aksionet e nëshkruara më parë.

Administratori është i detyruar të njoftojë për regjistrim, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, vendimin për zmadhimin e kapitalit.

NENI 10

Zvogëlimi i kapitalit themeltar

Zvogëlimi i kapitalit themeltar të Shoqërisë kryhet vetëm me Vendim të Asamblesë të Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë dhe në pajtim me dispozitat e neneve 181 deri 186 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Zvogëlimi i kapitalit themeltar mund të bëhet vetëm me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme e cila vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote apo përfaqësuesit e tyre, të cilët marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve. Zvogëlimi i kapitalit themeltar nuk duhet të çënojë raportin e aksionarit para këtij zvogëlimi.

Kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën shumën minimale të kërkuar nga ligji.

NENI 11

Të drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet

Çdo aksion jep të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet vjetore të Shoqërisë të destinuara për shpërndarje dhe në tepricën e aktivitetit të mbetur në rastin e likuidimit në përpjestim me aksionet që zotëron. Pronësia mbi aksionet jep edhe të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme në kushtet e përcaktuara në ligj dhe në statut.

Aksionarët përgjigjen për detyrimet e Shoqërisë ndaj të tretëve dhe për humbjet e saj deri në masën e shumës nominale të aksioneve që zotëron. Ndalohet kërkimi i fondeve të kësaj shume.

Kur aksionet u kalojnë aksionarëve të rinj, këta ruajnë të drejtat dhe detyrimet që vijnë nga aksionet. Pronësia e një aksioni përmban automatikisht të drejtën e aderimit në statutin e Shoqërisë dhe në vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.

KAPITULLI III ORGANET E SHOQËRISË

SEKSIONI I ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 12

Mbledhjet e Asamblesë dhe efektet detyruese të vendimeve

Të drejtat e aksionarëve, për çështjet e lidhura me veprimtaritë e funksionimit të Shoqërisë ushtrohen nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme. Çdo Asamble e mbledhur rregullisht përfaqëson tërësinë e aksioneve të zotëruara nga aksionari.

NENI 13

Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet si më poshtë të Shoqërisë:
përcaktimin e politikave tregtare;
ndryshime në statut;
emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës;
emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
miratimin e skemës së shpërblimeve për anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, Administratorit, likujduesit, ekspertët kontabël të autorizuar;
miratimin e pasqyrave financiare vjetore;
shpërndarjen e fitimeve vjetore;
zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
pjestimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë;
miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të saj;
çështje të tjera të parashikuara në ligj dhe statut.

NENI 14

Organizimi i mbledhjeve të Asamblesë

Asambleja thirret nga Administratori, Këshilli Mbikqyrës ose aksionarët të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

Ajo thirret të paktën një herë në vit. Asambleja mbledhet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrje, si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ashtu dhe jashtë territorit, e cila tregohet në njoftimin përkatës.

Thirrja e Asamblesë bëhet me anë të njoftimit me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike që i dërgohet aksionarëve së bashku me rendin e ditës, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar të mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë ditën, orën dhe vendin e mbledhjes, natyrën e Asamblesë, dhe rendin e ditës.

Kur Asambleja e mbledhur nuk ka mundur të marrë vendim për shkak se nuk është siguruar quorumi i kërkuar, mbledhja e dytë thirret jo më vonë se një muaj nga data e thirrjes së parë në të njëjtat forma si e para. Njoftimi ose letrat e thirrjes së mbledhjes së dytë rikujtojnë datën dhe rendin e ditës.

NENI 15

Rendi i ditës

Rendi i ditës së mbledhjes së Asamblesë që njoftohet si më sipër, duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje. Nëse Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për ndryshimin e statutit, teksti i ndryshimeve duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.

Administratori duhet t'i përgjigjet me shkrim, çdo kërkesë me shkrim për sqarim për rendin e ditës, dërguar nga aksionarët jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas formaliteteve si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë aksionarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Projektrezolutat dhe dokumentet shoqëruese duhet të mbërrijnë në selinë e Shoqërisë të paktën 5 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë.

NENI 16

Evidenca e pjesmarrjes, drejtimi i mbledhjes dhe procesverbalet

Një aksionar mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një aksionar tjetër apo nga një person i tretë.

Gjatë mbledhjes së Asamblesë përgatitet lista e aksionarëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë nënshkruhet prej tyre.

Rregulloret përkatëse të mbledhjeve mund të parashikojnë se aksionarët që nuk janë të pranishëm kanë mundësinë e pjesëmarrjes në Asamble me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjete elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i aksionarëve.

Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali duhet të përmbajë të dhënat vijuese: datën e mbledhjes, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit, vendimet e marra, qëndrimin e kryetarit për vendimarrjen, si dhe të aksionarëve që janë shprehur kundër. Procesverbalit i bashkëlidhen edhe lista e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali dhe lista e pjesëmarrësve duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit. Administratori është përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve.

Jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, Administratori është i detyruar të publikojë kopje të procesverbalit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme në faqen e internetit të Shoqërisë, për t'u konsultuar vetëm nga ana e aksionarëve të Shoqërisë.

NENI 17

Kuorumi

Për çështjet që vendosen me shumicë të zakonshme, Asambleja merr vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarë që zotërojnë më shumë se 30% të aksioneve, me të drejtë vote. Për çështje që kërkojnë shumicë të kualifikuar, Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse aksionarët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete të tjera elektronike.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të kërkuar, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

NENI 18
Marrja e vendimeve

Asambleja e Përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve, që marrin pjesë në votim në lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë. Për çështjet e tjera Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicën e votave të aksionarëve që marrin pjesë.

NENI 19
Mënyra e votimit

Asambleja e Përgjithshme merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur. Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës apo Administratorit Asambleja e Përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë kërkohet nga aksionarët që zotërojnë një numër aksionesh që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

NENI 20
Vënia në dispozicion të Aksionarit të dokumenteve dhe informacioneve

Shoqëria mban dhe vë në dispozicion të Aksionarit, në kushtet dhe në afatet e parashikuara nga ligji, raportet, dokumentet dhe llogaritë vjetore që shqyrton Asambleja. Me përjashtim të inventarëve dhe të ndonjë dokumenti tjetër të caktuar nga Asambleja, dokumentet që duhet t'u vihen në dispozicion Aksionarit u dërgohen këtij bashkë me njoftim-thirrjen për mbledhje.

SEKSIONI 2

KËSHILLI MBIKQYRËS
NENI 21

Përbërja dhe emërimi

Këshilli Mbikqyrës kryen funksion mbikqyrës për të gjithë veprimtarinë e Shoqërisë. Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga tre deri në 21 anëtarë të cilët nuk mund të jenë dhe Administratorë të Shoqërisë. Ata zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e votave të aksionarëve që marrin pjesë. Aksionerët e shoqërisë kanë të drejtë të përzgjedhin secili nga 1 (një) anëtar në përbërjen e Këshillit Mbikqyrës.

Anëtarët e parë të Këshillit Mbikqyrës do të jenë __ (____) në numër, si më poshtë vijon:

Z. _____, shtetas shqiptar, i datëlindjes ___/___/___, lindur në _____, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. _____;

Z. _____, shtetas shqiptar, i datëlindjes ___/___/___, lindur në _____, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. _____;

Z. _____, shtetas shqiptar, i datëlindjes ___/___/___, lindur në _____, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. _____;

Z. _____, shtetas shqiptar, i datëlindjes ___/___/___, lindur në _____, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. _____;

të cilët kanë pranuar detyrën.

Kohëzgjatja e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës do të jetë tre vjet. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen.

Këshilli Mbikqyrës, nga përbërja e tij ka një kryetar dhe një zëvendëskryetar që ngarkohen me organizimin dhe zhvillimin e mbledhjeve të Këshillit. Ata ushtrojnë funksionet e tyre gjatë tërë periudhës së mandatit të dhënë.

Kryetar i Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë do të jetë Z. _____, shtetas _____, i datëlindjes ___/___/___, lindur në _____, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. _____.

NENI 22

Mbledhjet dhe Vendimet e Këshillit Mbikqyrës

Statuti ose Këshilli Mbikqyrës mund të përcaktojë rregullore për procedurën e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit, si dhe të marrjes së vendimeve. Vendimet e Këshillit për këto rregullore duhet të jenë unanime.

Zhvillimi i mbledhjeve të Këshillit regjistrohet në një procesverbal, i cili duhet të nënshkruhet nga Kryetari. Procesverbal i përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara e vendimet e marra. Parregullsitë për mbajtjen e procesverbalit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të marra. Secili anëtar ka të drejtë të marrë një kopje të procesverbalit.

Vendimet e Këshillit Mbikqyrës vlerësohen si të vlefshme nëse në procesin e vendimarrjeve janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe kur për një çështje ka barazim votash, vota e kryetarit mbizotëron.

Vendimet e Këshillit të Mbikqyrjes mund të merren sipas përcaktimeve të statutit apo rregulloreve të Këshillit duke shprehur votën me shkresë, telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik që bëjnë të mundur identifikimin e anëtarit.

Anëtar i Këshillit Mbikqyrës nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës, nëse Këshilli Mbikqyrës duhet të marrë vendim për:

vlerësimin e veprimtarisë së tij;

faljen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;

ngritjen e nje padie ndaj tij nga Shoqëria;
dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

NENI 23

Kohëzgjatja e funksioneve të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës.

Kohëzgjatja e anëtarëve të parë të Këshillit Mbikqyrës është 3 vjet, me të drejtë rizgjedhje.

Ata mund të shkarkohen nga detyra me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me shumicë të thjeshtë votash.

NENI 24

Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës, me shumicë të thjeshtë votash, mund t'i kërkojë gjykatës të shkarkojë një anëtar në rastet e shkeljes së detyrave të parashikuara në pikën 3 të nenit 163 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 25

Shpërblimi i Anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës mund të përfitojnë pagë bazë e shpërblime shtesë, përfshirë këtu dhe pjesë nga fitimi i Shoqërisë apo të drejta opsioni mbi aksionet e Shoqërisë. Skema e këtyre shpërblimeve përgatitet nga Këshilli Mbikqyrës dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 26

Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Këshillit Mbikqyrës.

Këshilli Mbikqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

Të japë direktiva për Administratorin për zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë;

Të kontrollojë dhe të mbikqyrë zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë nga Administratori;

Të përgatisë me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave që janë kompetencë e kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë si dhe të zbatojë vendimet e Asamblesë;

Të kujdeset që Shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;

Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e Shoqërisë;

Të shqyrtojë dhe të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e Shoqërisë;

Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimatrisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, kryhen me saktësi nga Administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës për t'ju paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit Mbikqyrës për miratim dhe një përshkrim për mbikqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

Të sigurojë se auditimi i librave dhe regjistrimeve kontabël kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar Asamblesë së Përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës. Raporti i Këshillit Mbikqyrës të përmendur në pikën 7 më sipër, duhet të përmbajë dhe mendimin për raportin e auditimit;

Të emërojë dhe të shkarkojë Administratorin, si dhe të përcaktojë kompetencat e tij.

Të përcaktojë shpërblimin e Administratorit;

Të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5% të aseteve të Shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare, të çertifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumentave të tjera të borxhit;

Të vendosë krijimin e bashkëpunimeve afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;

Të miratojë kalimin e aksioneve me propozim të Administratorit të Shoqërisë;

Të kryejë veprimet e tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;

Këshilli Mbikqyrës duhet të thërrasë menjëherë Asamblenë e Përgjithshme në rastet si më poshtë:

Kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezultojnë apo parashikohet se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50% të kapitalit ose që aktivet e Shoqërisë nuk mbulojnë detyrime që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.

Kur Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të Shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Kur brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozon të blejë nga një aksionar pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të Shoqërisë.

Kryetari i Këshillit Mbikqyrës ushtron të drejtën e përfaqësimit të shoqërisë në të gjitha marrëdhëniet me Federatën Shqiptare të Futbollit.

NENI 27

Person Juridik anëtar i Këshillit Mbikqyrës

Një person juridik që është aksionar i Shoqërisë nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Mbikqyrës. Ata janë individë të cilët duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga Administratori i Shoqërisë.

NENI 28 Administratorët

Administratorët drejtojnë dhe administrojnë shoqërinë dhe marrin vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare.

Administratori i parë i Përgjithshëm është Z. _____, shtetas shqiptar, i datëlindjes ____/____/____, lindur në ____ dhe banues në _____, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. _____.

NENI 29 Emërimi dhe shkarkimi

Administratorë të shoqërisë mund të jetë një ose disa persona fizikë. Ata emërohen nga Këshilli Mbikqyrës për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se tre vjet. Ata mund të rizgjidhen.

Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë kryetar i këshillit mbikqyrës të një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Këshilli Mbikqyrës ka të drejtë të shkarkojë administratoret në çdo kohë.

NENI 30 Te drejtat dhe përgjegjësitë

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen:

- Të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
 - Të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - Të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël të shoqërisë;
 - Të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit mbikqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për tu paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;
 - Të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
 - Të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
 - Të raportojnë përpara këshillit mbikqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
 - Të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;
- Administratorët duhet të informojnë menjëherë kryetarin e këshillit mbikqyrës në rastet kur:

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton apo parashikohet se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50% të kapitalit ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrime që janë të kerkueshme brenda 3 muajve në vijim.

shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozohet blerja nga një aksionar e pasurisë që ka vlerë më të lartë se 5% e aseteve të shoqërisë,

NENI 31

Përfaqësimi i shoqërisë

Adminstarorët përfaqësojnë shoqërinë në lidhje me të tretët. Administratorët të cilët kanë të drejtë të përfaqësojnë shoqërinë tregtare në mënyrë të përbashkët, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara.

Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 32

Detyrime dhe përgjegjësi të përbashkëta të Këshillit Mbikqyrës dhe Administratorëve

Adminsitatorët dhe anëtarët e këshillit mbikqyrës detyrohen:

të kryejnë detyrat e tyre në mirëbesim e në interesin e shoqërisë;

të ushtrojnë kompetencat që u jep ligji dhe statuti;

të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat merret vendim;

të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundshme të interesave personale me ata të shoqërisë;

të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

Ata përgjigjen ndaj shoqërisë për cdo veprim ose mosveprim gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Ata përgjigjen në mënyrë solidare për vërtetësinë e të gjitha pasqyrave financiare, të publikimeve të detyrueshme dhe informacioneve të tjera kryesore të veprimitarisë së shoqërisë.

NENI 33

Mbikqyrja e veçantë

Aksionarët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit bazë ose një përqindje më të vogël të parashikuar në statut apo kreditorët e shoqërisë, pretendimet e të cilëve ndaj saj janë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar, mund ti kërkojnë këshillit mbikqyrës të kryejë mbikqyrje të veçantë për çështje të posaçme sidomos kur merret në shqyrtim ligjshmëria e veprimeve të administratorëve.

KAPITULLI IV EKSPERTËT KONTABËL

NENI 34 Emërimi dhe shpërblimi

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtën për të caktuar një ose disa ekspertë kontabël të zgjedhur nga listat e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

Në caktimin e ekspertëve mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtueshmëritë e përcaktuara në rregullat e posaçme. Ekspertët kontabël caktohen për një kohë që i përgjigjet një ushtrimi financiar. Ata janë të ricaktueshëm.

Shpërblimi i ekspertëve kontabël të autorizuar caktohet nga asambleja e përgjithshme dhe përballohet nga shoqëria.

Shoqëria Tregtare "_____ " SH.A do të ketë ___ (___) ekspert kontabël.

NENI 35 Detyrat dhe të drejtat

Detyrat dhe të drejtat e ekspertëve kontabël të autorizuar të shoqërisë janë ato të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi

Asambleja e përgjithshme mund t'u kërkojë ekspertëve kontabël të autorizuar kryerjen e kontroleve apo verifikimeve të posaçme për çështje me interes të shoqërisë. Me marrjen e raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar asambleja miraton raportin dhe bilancin e shoqërisë. Raportet që ata përgatisin depozitohen në selinë e shoqërisë, në afatet e parashikuara nga ligji

KAPITULLI V LLOGARITË VJETORE, CAKTIMI I REZULTATIT

NENI 36 Viti financiar

Shoqëria përgatit çdo vit financiar llogaritë vjetore në pajtim me ligjin për kontabilitetin. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

NENI 37 Caktimi i rezultateve

Rezultati i vitit financiar nxirret dhe caktohet në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe mbas dhënies së raportit përfundimtar nga ekspertët kontabël të autorizuar.

NENI 38 Fitimet dhe fondi rezervës

Fitimet që rezultojnë nga bilanci ushtrimor do të shpërndahen sipas një vendimi përkatës së Asamblesë ndërmjet aksionerëve pasi të jenë zbritur nga kjo shumë taksat dhe tatimet sipas ligjit, vlera e humbjeve të pësuar gjatë vitit ushtrimor paraardhës si dhe 5 % (pesë

për qind) që destinohet për fondet e rezervës së domosdoshme, derisa kjo të ketë arritur nivelin maksimal prej 1/10 e kapitalit themeltar.

Aksionerët mund të vendosin sipas ligjit për një destinim të ndryshëm të fitimit të pashpërndarë. Me vendimin e miratimit të bilancit ushtrimor, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë t'i destinojë fitimet që i takojnë ortakëve në formë dividendi për zmadhim të kapitalit themeltar, investime ose mbartje, etj.

KAPITULLI VI

PRISHJA, LIKUJDIMI, KUNDËRSHTIMET

NENI 39

Prishja, likuidimi

Shoqëria aksionare priset:

kur mbaron kohëzgjatja për të cilën është themeluar

kur merr vendim asambleja e përgjithshme

me hapjen e procedurave të falimentimit

kur nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit

me vendim gjykate.

Shoqëria aksionere likuidohet në dy mënyra, likuidimi i zakonshëm dhe likuidimi i thjeshtëzuar.

Likuidimi i zakonshëm kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme.

Në rast se asambleja nuk merr vendim për caktimin e likuiduesit ai zgjidhet nga gjykata.

Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve.

Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve apo aksionarëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference.

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

Për sa i përket likuidimit të thjeshtëzuar ky mund të kryhet nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët apo aksionarët dhe kur këta

deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit. Administratorët njoftojnë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar, gjithashtu ata janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtë.

NENI 40 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Të gjitha mosmarrëveshjet gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj që lindin midis shoqërisë dhe Aksionerit ose midis vetë Aksionerëve, lidhur me veprimtarinë e shoqërisë, i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

KAPITULLI VII **DISPOZITA TË FUNDIT.**

NENI 41

Nëpunësit, të zgjedhurit nga Organet drejtuese të shoqërisë, e personat që punojnë për llogari të saj, mbajnë përgjegjësi penale e civile sipas ligjit përkatës kur me dashje shkelin detyrat e ngarkuara e i shkaktojnë humbje Shoqërisë.

NENI 42

Statuti hyn në fuqi mbas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Gjithçka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në veçanti ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

NENI 43

Statuti i Shoqërisë pasi u lexua nga Aksionarët e Shoqërisë u nënshkrua prej tyre pa vërejtje para Noterit të vendit të themelimit të Shoqërisë. Ky Statut hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe.

AKSIONARËT E SHOQËRISË

BASHKIA URA VAJGURORE

e përfaqësuar nga ZN.JJULIANA MEMAJ

**SHOQËRIA TREGTARE
“FK OSUMI ” SH.A**

BERAT më 21/05/2019

AUTORIZIM PËRFAQËSIMI

Shoqëria “FK OSUMI ” sh.a, shoqëri në krijim e sipër e përfaqësuar nga Administratori i saj , Z. Albano Kora , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, autorizojnë Albano Kora dhe _____, të cilëve iu jep të drejta dhe kompetenca të plota për të përfaqësuar së bashku, ose vec e vec shoqërinë “_____” sh.a, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, për ndjekjen e të gjitha procedurave për Regjistrimin e kësaj shoqëri në Regjistrin Tregtar. Gjithashtu avokatet kanë të drejtë që në të ardhmen të ndjekin procedura e nevojshme në rast ndryshimesh që do të ndërmerren nga shoqëria për t’i pasqyruar ato në Regjistrin Tregtar.

Po kështu ato kanë të drejtë të kryejnë cdo lloj veprimi tjetër që nuk është shprehur në këtë autorizim, por që është në interesin e shoqërise.

Të gjitha veprimet e tyre ne i konsiderojmë të drejta dhe të mirëqena sikur të ishin kryer vetë prej nesh dhe për to shoqëria mban përgjegjësi përpara të tretëve.

AUTORIZUES

SHOQËRIA FK OSUMI ” SH.A

Administratori



REPUBLIKA E SHQIPËRSIË
BASHKIA URA VAJGURE
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr 52 Datë 13/05/2019

**MBI MIRATIMIN E AKTIT TË THEMELIMIT TË SHOQËRISË:
KLUBI I FUTBOLLIT "FK OSUMI" SH.A**

Këshilli i Bashkisë Ura Vajgurore në mbledhjen e datës 13/05/2019, mbi bazën e materialit të paraqitur nga Sektori i Arsim Kultures dhe Sporteve ,Drejtoria Juridike Prokurimeve dhe Burimeve Njerezore, Drejtoria e Finances në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore "Neni 9:Të drejtat dhe përgjegjësitë,Neni 25 Funkcionet e Bashkise ne fushen e kultures sportit dhe sherbimeve argetuese,Neni 41 Buxheti i njesive te qeverisjes vendore., Neni 53 Funkcionimi i këshillit bashkiak,Neni 54 pika d ,Neni 55, Ligji NR 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare " ,i ndryshuar,Ligji Nr 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit " ,i ndryshuar

VENDOSI :

Me 12 vota PRO nga 12 Këshilltarë prezentë të miratojë :

**1.Miratimin e :AKTIT TË THEMELIMIT TË SHOQERISE : "KLUBI I FUTBOLLIT"
{FK OSUMI} SH.A**

2.Për zbatimin e këtij Vendimi dhe vazhdimin e procedurave të mëtejshme ligjore ngarkohen :
Sektori i Arsim Kulturës dhe Sporteve,Drejtoria Jurdike,Drejtoria e Finances .

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve në ligjin Nr 139/2015"Për Vetëqeverisjen
Vendore".

Për konfirmim në Prefekturë
Sekretari i Këshillit Bashkiak
Elis Gjata



Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hysen Hoxha

Adresa: Lagjia. "18 Tetori" Rr. "Dimal "
web:Uravajgugore.gov.al

Tel: 036122468
e-mail: bashkia@uravajgurore.gov.al